



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Metoda dhe Metodologji të Mësimdhënies së Gjuhës Së Huaj

Ngarkesa: 5 kredite; 50 orë mësimore; 40 leksione / 10 seminare

Viti /Semestri: Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Mësuesi i Gjuhës Greke për Arsimin e Mesëm të Lartë”

Kodi i etikës :Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNI

Objektivat e përgjithshme të lëndës: Të kuptohet dhe analizohet struktura e proceseve të mësimdhënies dhe të nxënies së gjuhës së huaj;Të zhvillohet një bazë teorike solide për vlerësimin dhe përdorimin e metodave dhe qasjeve pedagogjike;Të përforcohet ndërgjegjësimi profesional për rolin e mësuesit të gjuhës në një kontekst dinamik dhe multikulturor.

Objektivat specifike të lëndës

- 1.Të identifikohen dallimet ndërmjet metodave tradicionale dhe qasjeve moderne të mësimdhënies;
- 2.Të formulohet një plan mësimor me komponentë të integruar (gjuhësor, kulturor, teknologjik);
- 3.Të zbatohen metoda vlerësimi formativ dhe përmbledhës sipas niveleve të kompetencës gjuhësore;
- 4.Të zhvillohet aftësia për të reflektuar mbi praktikën didaktike dhe për të sugjeruar përmirësime.